

Thirrja është e hapur nga data 14.05.2026 deri me 20.05.2026

## TERMAT E REFERENCËS

### SIGURIMI I SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATËS “NEVO KONCEPTI”

<b>Organizata</b>	<b>OJQ “NEVO KONCEPTI”</b>
<b>Objektiva</b>	<b>Sigurimi i transportit, për realizimin e aktiviteteve të organizatës “Nevo Koncepti”</b>

#### 1. Të dhënat për Organizatën

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektual të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë, Prishtinë, Mitrovicë, Klinë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

#### 2. Përshkrimi i shërbimeve të kërkuara

Operatori ekonomik do të ofrojë shërbime transporti për pjesëmarrësit e aktiviteteve të organizuara nga OJQ “Nevo Koncepti”, sipas kërkesave në vijim:

##### Transporti

- Organizimi i transportit vajtje-ardhje me autobus/minibus komod deri në Prishtinë;
- Transporti duhet të realizohet me data 23, 24 dhe 30 maj 2026.
- Pjesëmarrësit, secilën ditë duhet të merren nga këto qytete:
  - Prizren – 8 pjesëmarrës
  - Ferizaj – 5 pjesëmarrës
  - Gjakovë – 19 pjesëmarrës
  - Pejë – 9 pjesëmarrës
  - Klinë – 5 pjesëmarrës
- Numri i pjesëmarrësve nga Ferizaj mund të rritet deri në 2 (dy) pjesëmarrës shtesë;
- Itinerarin e udhëtimit e organizon operatori ekonomik/agjencia në koordinim me organizatën;
- Në kthim, pjesëmarrësit duhet të dërgohen në të njëjtat lokacione nga ku janë marrë;
- Mjetet transportuese duhet të jenë në gjendje të rregullt teknike, të pajisura me dokumentacionin përkatës dhe të plotësojnë standardet e sigurisë dhe komoditetit për udhëtarët.

### **3. Kushtet e pagesës**

Pagesa e shërbimeve do të realizohet pa TVSH, pasi Organizata “Nevo Koncepti” është e liruar nga TVSH.

Pagesa do të kryhet pas realizimit të shërbimit dhe pranimit të faturës përkatëse, në përputhje me marrëveshjen ndërmjet palëve.

### **4. Afati kohor**

Konfirmimi final për ofertën dhe numrin e pjesëmarrësve do të bëhet me kohë, në përputhje me marrëveshjen ndërmjet palëve.

### **5. Rezultatet e pritshme**

- Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe profesionale të transportit;
- Bashkëpunim korrekt dhe profesional ndërmjet palëve;
- Respektimi i orarit dhe itinerarit të dakorduar;
- Çmimet e ofruara të mbeten të pandryshuara gjatë periudhës së kontratës/marrëveshjes.
- 

### **6. Procedura e aplikimit**

Të gjithë të interesuarit duhet t’i dërgojnë këto dokumente:

- Kërkesa për ofertë (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur)
- Oferta (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur)
- Kopja e regjistrimit të biznesit me numër unik identifikues

Aplikimi duhet të dërgohet jo më larg se data **20.05.2026** në adresën elektronike [prokurimi@nevokoncepti.org](mailto:prokurimi@nevokoncepti.org)